



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 770/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.10.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Iris” sh.p.k nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-37819-05-13-2016 me objekt: *“Blerje materiale mjekësore për hemodinamikën-Loti 3-Materiale për Studime Elektrofiziologjike dhe Mjekim të Artimive Madhore të Zemrës”*, me fond limit 12.418.166.70 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 08.06.2016, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Uuniveristare “Nënë Tereza “ Tiranë.

Ankimues:

“IRIS” shpk.
Rruga Isa Boletini,28 .

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza “,Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I


Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 13.05.2016 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-37819-05-13-2016 me objekt: “Blerje materiale mjekësore për hemodinamikën-Loti 3-Materiale për Studime Elektrofiziologjike dhe Mjekim të Artimive Madhore të Zembrës”, me fond limit 12.418.166.70 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 08.06.2016, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Uuniveristare “Nënë Tereza “ Tiranë.

II.2. Në datën 08.06.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 22.06.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

Bylis Pharma	pa ofertë	I skualifikuar
Montal	pa ofertë	I skualifikuar
Iris	9,717,400.00	I skualifikuar
O.E.S Distrimed	9,786,650.00	I kualifikur
Biometric Albania	9,978,000.00	I kualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “IRIS” sh.p.k. është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

- *Konkretisht operatori ekonomik Iris sh.p.k ka paraqitur Ekstrakt të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit dhe ekstrakt historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit nga verifikimi i së cilës rezultoi se afati i emërimit të administratorit Z.Arben Hoxha ka përfunduar më datë 12.05.2016. Si rjedhojë cdo dokument i nënshkruar që lidhet me kryerjen e veprimeve si administrator nga Z. Arben Hoxha është i pavlefshëm. Si Formulari i Ofertës, Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, Deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore, Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike .*

II.5. Në datën 23.06.2016, operatori ekonomik ankimues “IRIS” sh.p.k., kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

- *Shoqëria jonë ,që nga krijimi i saj më datë 06.12.1993 e deri më sot,ka patur dhe vazhdon të ketë të njëjtin administrator dhe Ortak të vetëm, z.Arben Hoxha. Rinovimi i mandatit të Administratorit,sipas ligjit 9901,datë 14.04.2008,bëhet për një periudhë 5 vjeçare. Në rastin tonë,bazuar në ligjin 9901,datë 14.04.2008 , “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “,në rastin kur nuk është bërë riemërimi i Administratorit, përgjegjësia e administrimit të shoqërisë i kalon Ortakut të vetëm. Rinovimi i administratorit nuk përbën problem dhe nuk sjell bllokim të aktivitetit të shoqërisë, sepse rolin e administratorit e merr automatikisht ortaku i vetëm. Kjo bazuar në ligjin 9901,neni 31 – Administrimi,Pika 1,e cila thotë :” Të gjithë ortakët kanë të drejtë ta administrojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë kolektive, duke vepruar si administratorë. Gjithashtu në nenin 33 – Objekti i Administrimit,pika 1 ,thuhet “E drejta për administrim përfshin kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për ushtrimin e zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë”.Rrjedhimisht ortaku i vetëm merr të drejtën ligjore të kryejë rolin e administratorit me të gjitha detyrat dhe të drejtat që ligji i përcakton atij. Po në ligjin e lartpërmendur,pavarësisht se mund të ketë ndonjë parregullsi në emërimin e administratorit (si në rastin tonë) ,një fakt i tillë nuk e përjashton shoqërinë nga përgjegjësia. Kjo bazuar në titullin III- Përfaqësimi,Neni 12-përfaqësuesit Ligjore ,Pika 4 , e cila thotë : Çdo parregullsi në emërimin e përfaqësuesit ligjor nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e shoqërisë ndaj palëve të treta”.Pra pavarësisht mosrinovimit të emërimit të administratorit,shoqëria jonë nuk përjashtohet nga përgjegjësia e prezantimit të një oferte dhe realizimit të saj. Gjithashtu shoqëria jonë gjatë kësaj kohe ka realizuar blerje,shitje,pages ataksash e detyrimesh të tjera ndaj subjekteve shtetërore e private,të cilat janë bërë të gjitha me firmën e Ortakut të Vetëm dhe në asnjë rast dhe nga asnjë institucion nuk janë konsideruar të pavlefshme. Prandaj,bazuar në argumentet e mësipërme,mendojmë se dokumentet e paraqitura nga ana jonë në tenderin e lartpërmendur ,të cilat janë firmosur nga z.Arben Hoxha, Ortaku i Vetëm i shoqërisë “IRIS” sh.p.k janë të vlefshme dhe duhen marrë në konsideratë.*

II.6. Në datën 29.06.2016, me shkresën nr.3349/2 prot, operatori ekonomik ankimues “IRIS” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 08.07.2016, pala ankimuese “IRIS” sh.p.k.,ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor:

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 3711/1 datë 15.07.2016, protokolluar me tonën me nr.1995/2 prot datë 15.07.2016, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Iris” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *“afati i emërimit të administratorit Z.Arben Hoxha ka përfunduar më datë 12.05.2016. Si rjedhojë cdo dokument i nënshkruar që lidhet me kryerjen e veprimeve si administrator nga Z. Arben Hoxha është i pavlefshëm. Si Formulari i Ofertës,Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit,Deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore,Deklaratë mbi përmbuhsjen e specifikimeve teknike”* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..*

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. *Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):*
 - a) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*
 - b) *nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
 - c) *nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,*

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 9 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues “Iris sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt i Rregjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” Iris sh.p.k
- Ekstrakt Historik i Rregjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” Iris sh.p.k

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër, Komisioni konstaton se në seksionin 10 të ekstraktit historik të subjektit me titull “Administratori” “Afati i Emërimit” rezulton në cilësinë e administratorit të shoqërisë Z.H me afat emërimi nga data 12.05.2011-12.05.2016. Gjithashtu në seksionin 12 të ekstraktit të regjistrimit tregtar të ankimuesit rezulton se Z.A.H është ortaku i vetëm i shoqërisë “Iris” sh.p.k.

III.1.5. Neni 95 i Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” i ndryshuar “Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet” parashikon shprehimisht se 1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.1.6. Neni 12 “Përfaqësuesit ligjorë” i ligjit të sipërcituar parashikon shprehimisht se: Shoqëritë tregtare përfaqësohen sipas rregullave të përcaktuara nga ky ligj dhe dispozitave të statutit. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

2. Përfaqësuesit ligjorë zbatojnë të gjitha kufizimet e tagrave të përfaqësimit, të përcaktuara në statut apo të miratuara nga organet përkatëse të shoqërisë. Me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për kufizimin, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të, kufizimi i kompetencave nuk mund t’i kundrejtohet palëve të treta, edhe nëse këto kufizime janë bërë publike në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Publikimi i kufizimit nëpërmjet publikimit të vendimeve të organit përkatës të shoqërisë apo statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky kufizim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3. Veprimet e kryera nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t’u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Çdo parregullsi në emërimin e përfaqësuesit ligjor nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e shoqërisë ndaj palëve të treta, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për parregullsinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Në interpretim të bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni gjykon se ligjvënësi ka përcaktuar shprehimisht se cdo parregullsi në emërimin e administratorit nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e shoqërisë ndaj palëve të treta cka do të thotë se pavarësisht kapërcimit të afatit ligjor të administratorit shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha aktet/veprimet/mosveprimet e administratorit të saj, në rastin kur konstatohet se i njëjti person është ortaku i vetëm i shoqërisë dhe njëherazi administrator i saj.

III.1.7. Për më tepër, Komisioni i Prokurimit verifikoi gjendjen aktuale të shoqërisë nëpërmjet faqes zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe konstatoi se në cilësinë e administratorit vijon të mbetet Z.A.H i cili është edhe ortaku i vetëm (me afat emërimi nga data 12.05.2011-12.05.2021) i shoqërisë cka konfirmon edhe një herë se shoqëria krijon besueshmëri, bindje dhe seriozitet për përmbushjen e detyrimeve dhe realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Ndodhur përpara faktit se në rastin konkret përputhet tërësisht vullneti i ortakut të shoqërisë me vullnetin e administratorit i cili ka nënshkruar dokumentacionin tekniko ligjor për pjesmarrje në procedurën e prokurimit objekt ankimi konfirmohet se shoqëria ka shprehur vullnetin e saj për marrjen përsipër të të gjitha angazhimeve konkrete për realizimin me sukses të kontratës.

III.1.8. Neni 53 “Shqyrtimi i Ofertave” i Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkoet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

Në kuptim të nenit të sipërcituar, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor mund dhe duhet ti kishte kërkuar sqarime ofertuesit lidhur me mosripërtëritjen e afatit të administratorit nëse ky fakt ka ndodhur si shkak i ndonjë pakujdesie apo për shkak të vullnetit të vetë shoqërisë për mosrinovim të afatit të administratorit.

Refruar sa më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik nuk është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

Komisioni vlerëson se argumenti i autoritetit kontraktor për pavlefshmëri të të gjithë dokumentacionit “Ofertë ekonomike, Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, Deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore, Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike” të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Iris” sh.p.k nuk qëndron, kjo pasi ortaku i vetëm i shoqërisë i cili mban efektivisht pozicionin e administratorit të saj nëpërmjet nënshkrimit të dokumentacionit ka shprehur vullnetin e tij të plotë dhe interesin për pjesmarrje në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që ofertuesi të dëshmojë besueshmëri dhe seriozitet në marrjen e angazhimeve konkrete për realizimin e kontratës.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku parashikohet shprehimisht se autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm për vetë cilësimin e tij ligjor si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltetet e parashikuara në 7 kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, të sipër cituar.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Iris” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-37819-05-13-2016 me objekt: “Blerje materiale mjekësore për hemodinamikën-Loti 3-Materiale për Studime Elektrofiziologjike dhe Mjekim të Artimive Madhore të Zemrës”, me fond limit 12.418.166.70 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 08.06.2016, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Uuniveristare “Nënë Tereza “ Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Iris” sh.p.k, dhe të korigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Iris” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1595 Protokolli; Datë 08.07.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha